

Tiranë, më 11.07.2019

KËRKESË-PADI

Paditësi: Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë (SH.K.GJ.R.SH), regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 2160, datë 25.01.2008, përfaqësuar me autorizim nga **Z.Florjan Kalaja** me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe **Z.Engert Pëllumbi**, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe njëkohësisht nënkryetar i SH.K.GJ.R.SH. Adresa e njoftimit pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.¹

I paditur: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

TIRANË

Objekti: 1. Konstatimin e cënimit të statusit të gjyqtarit nëpërmjet heqjes së pasaportës së shërbimit me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.06.2019, *“Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit”*, si një e drejtë e fituar e që *“nuk mund të ulet”*, në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.

2. Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e Lidhjes 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.06.2019, *“Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit”* në pjesën që nuk parashikon gjyqtarët si subjekte zyrtarë që kanë të drejtë të pajisen me pasaportë shërbimi.

3. Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e pikës 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.06.2019 *“Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit”* në pjesën që parashikon se pasaportat e shërbimit të gjyqtarëve të lëshuara para datës 14 Qershor 2019 humbin vlefshmërinë me datë 31 Dhjetor 2019.

Baza ligjore: Nenet, 4, 116, 118 dhe 138 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenet 1, 2, shkronja “gj”, 10 dhe 22 të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*; Nenet 2, pika 3, 7, shkronja “a”, 10, pika 2, shkronja “b”, neni 15 shkronja “d”, neni 17, pika 1, shkronja “a”, neni 18, pika 3, neni 37, pika 3 dhe 4, neni 40, pika 1, shkronja “a”, dhe neni 43, pika 2, e Ligjit nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*.

¹ Njoftimi i komunikimeve do të bëhet pranë vendit të punës ku aktualisht ushtrojnë detyrën e Këshilltarit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë përfaqësuesit Z.Florjan Kala dhe Z.Engert Pëllumbi.

PËRPARA GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT TIRANË,

Të nderuar z./znj. Gjyqtar/e!

Po ju paraqesim më poshtë kërkesë-padinë tonë duke parashtruar faktet dhe rrethanat, ligjin përkatës, ku jemi mbështetur, analizën dhe arsyetimin ligjor, për të arritur në konkluzionin se kërkesë-padia jonë duhet pranuar.

I. Faktet e çështjet

1. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 02.09.1997 “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit” (të ndryshuar), në pikën 4, ndër të tjera parashikohej se gjyqtarët e gjykatës së shkallës së parë kanë të drejtë të pajisen me pasaportë shërbimi gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Më tej në pikën 11 parashikohej se: “Lëshimi i pasaportave diplomatike dhe të shërbimit ose zgjatja e afatit të vlefshmërisë së tyre bëhet kundrejt pagesës sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave. Këto pagesa përballohen nga organet, institucionet ose organizmat që kërkojnë lëshimin apo zgjatjen e afatit të vlefshmërisë të pasaportave për punonjësit e tyre.”.

2. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.06.2019, “Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit” është ndryshuar rrethi i subjekteve zyrtarë që gëzojnë të drejtën për shkak të funksionit të pajisen me pasaportë diplomatike dhe shërbimi. Ndër të tjera, në Lidhjen 2 të këtij akti nënligjor normativ, lidhje e cila parashikon listën e subjekteve zyrtarë që gëzojnë të drejtën të mbajnë pasaporta shërbimit, **nuk përfshihen gjyqtarët**. Për rrjedhojë nuk parashikohet më as përballimi i shpenzimeve për pajisjen me pasaportë të gjyqtarëve nga institucioni ku ato ushtrojnë detyrën. Në pikën 14 të këtij akti nënligjor normativ parashikohet se pasaportat e shërbimit të dhëna më parë do të kenë vlefshmëri deri me datë 31.12.2019.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.06.2019, “Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit” (në vijim VKM nr. 389/2019) është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, të vitit 2019, ditën e premte, me datë 14 Qershor 2019. Në pikën 15, në paragrafin e dytë parashikohet se ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Kjo do të thotë se VKM nr. 389/2019 ka hyrë në fuqi me datë 14 Qershor 2019.

II. Ligji i zbatueshëm

4. Dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilat është parashikuar:

4.1. Preambula e Kushtetutës në të cilën aspirohet shteti i së drejtës: “Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, **me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës**, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin

dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit.”.

4.2. Neni 4 i Kushtetutës: “1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. 2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë. 3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.”.

4.3. Neni 116 i Kushtetutës: “1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave. 2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe. 3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.”.

4.4. Neni 118 i Kushtetutës: “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. 3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t’ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.”.

4.5. Neni 138 i Kushtetutës: “**Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen**, përveç rasteve kur: a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare; b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit; c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.”.

5. Dispozitat e Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në të cilat është parashikuar:

5.1. Neni 1 i Ligjit Nr. 96/2016 parashikon: “1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i statusit të magjistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me: a) të drejtat dhe detyrimet e tyre; b) pranimin dhe emërimin e tyre; c) zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre; ç) vlerësimin etik dhe profesional të tyre; d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre; 2. Sipas parashikimeve të këtij ligji, statusi gëzohet ligjërisht nga një person që sapo emërohet në funksion dhe përfundon me mbarimin e statusit të magjistratit.”.

5.2. Neni 2, shkonja “gj” i Ligjit Nr. 96/2016 parashikon: “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ...**gj**) “Magjistrat” është gjyqtari, me përjashtim të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, prokurori dhe kryetarët në kuptim të shkronjës “g” të këtij neni.”.

5.3. Neni 10 i Ligjit Nr. 96/2016 parashikon: “1. Magjistratët kanë të drejtë të themelojnë shoqata ose organizata dhe të marrin pjesë në to, me qëllim: a) mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre; b) ngritjen e tyre profesionale. 2. Shoqatat ose organizatat e magjistratëve në ushtrimin e aktivitetit nuk duhet të bien ndesh me kompetencat e institucioneve të drejtësisë.”.

5.4. Neni 22 i Ligjit Nr. 96/2016 parashikon: “1. **Paga dhe përfitimet e tjera të magjistratit nuk mund të ulen**, me përjashtim të rasteve kur: a) ka situata të vështira financiare në vend ose emergjenca të tjera kombëtare, duke marrë parasysh faktorët si vijon: një mospërputhje e qartë midis dinamikës së pagave të magjistratëve dhe dinamikës së pagave standarde në shërbimin civil; indeksi i pagesave, ashtu si dhe indeksi i çmimeve të konsumatorit. Këta faktorë është e nevojshme që të vlerësohen, për të gjetur balancën mes

paprekshmërisë së pagës dhe nevojës për të shmangur marrjen e borxheve të reja; b) magjistrati ushtron të drejtën për t'u kthyer nga një pozicion i mëparshëm më i lartë ose më i specializuar ose me mandat të kufizuar dhe me pagesë më të lartë; c) magjistrati ka masë disiplinore; ç) vjen si pasojë e një vlerësimi të ulët etik dhe profesional, sipas parashikimeve të këtij ligji. 2. Magjistrati duhet të kthejë shumat e përfituara të pagës ose përfitimeve financiare nëse ka përfituar më shumë sesa është parashikuar në ligj.”.

6. Dispozitat e Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në të cilat është parashikuar:

6.1. Neni 2, pika 3, i Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 parashikon: “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:3. “**Akt nënligjor normativ**” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron në zbatimin e tij.”.

6.2. Neni 7, shkonja “a”, i Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 parashikon: “Gjykatat administrative janë kompetente për: **a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;..**”.

6.3. Neni 10, pika 2, gërma “b” i Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 parashikon: “2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:b) në shkallë të parë, **mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj.**”.

6.4. Neni 15 i Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 parashikon: “Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: **a) çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik;d) çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik: i) nga një akt normativ; ii) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj; dh) çdo subjekt tjetër, të cilit kjo e drejtë i njihet shprehimisht me ligj.**”.

6.5. Neni 17, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 parashikon: “Padia ngrihet: ...a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;

6.6. Neni 18, pika 3, i Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 parashikon: “3. **Padia kundër aktit nënligjor normativ duhet të paraqitet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të aktit.**”.

6.7. Neni 37, pika 3 dhe 4, i Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 parashikon: “3. Në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për zgjedhje alternative, në nxjerrjen e një akti administrativ apo në kryerjen e veprimit tjetër administrativ, gjykata shqyrton edhe nëse: a) zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit; b) zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit; c) zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë. 4. **Në rastin e aktit nënligjor normativ, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit që kundërshtohet, duke vlerësuar të tre kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.**”.

6.8. Neni 40, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 parashikon: “1. Gjykata, në vendimin e saj përfundimtar të pranimit, tërësisht ose pjesërisht të padisë, vendos: a) shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;

6.9. Neni 43 i Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 parashikon: “1. Të gjitha vendimet e gjykatës publikohen në mënyrën dhe me mjetet e përshtatshme. 2. **Vendimi për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ, me kërkesë të gjykatës që ka dhënë vendimin, publikohet i plotë, në të njëjtën mënyrë me atë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për botimin e aktit.**”.

III. Vlerësimi ligjor

1. Lidhur me legjitimitetin e palëve ndërgjyqëse.

7. Palët në procesin gjyqësor duhet të kenë legjitimitet. Në nenin 31 parashikohet se: “Padia është e drejta e personit që bën pretendimin për t’u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi ...”. Ndërsa në nenin 32, mes të tjerave parashikohet se: “Padia mund të ngrihet ... a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur..... b) për vërtetimin e qënies ose mosqënies së një marrëdhënie juridike ose një të drejte”. Gjithashtu, në nenin 15 të Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 parashikohet se: “Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: a) çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik;d) çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik: i) nga një akt normativ; ii) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj; dh) çdo subjekt tjetër, të cilit kjo e drejtë i njihet shprehimisht me ligj.”. E drejta e ngritjes së padisë lidhet me vërtetimin e ekzistencës së një interesi të ligjshëm të palës që e ngre atë padi, interes që ka të bëjë me njohjen ose rivendosjen e një të drejte që i mohohet ose shkelet nga një pale tjetër e tretë, gjë të cilën paditësi mund ta realizojë e mbrojë nëpërmjet investimit, “ndërhyrjes” së gjykatës.² Interesi në gjykim përcakton edhe pozitën procedurale të palëve në proces. Kështu, personi që, duke pretenduar se e drejta subjektive i takon atij, i drejtohet gjykatës për të kërkuar njohjen ose rivendosjen e kësaj të drejte të shkelur nga një person tjetër që e thërret në gjykim, quhet paditës (legjitimimi aktiv). Ndërsa, personi të cilit i drejtohet kërkimi, duke pretenduar se është ky person që ka shkelur, cenuar apo mohuar të drejtën e paditësit, quhet i paditur (legjitimimi pasiv). Legjitimimi aktiv konsiderohet ndryshe si legjitimimi për të kërkuar, ndërsa legjitimimi pasiv, si legjitimi për të kundërshtuar. Legjitimimi procedural është kusht për vazhdimin e gjyqimit, ndërsa legjitimimi real i takon shqyrtimit gjyqësor të themelit të çështjes, për të cilin gjykata shprehet në vendimin përfundimtar.³ Pra, që të justifikohet ligjërisht, kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti (legjitimimi aktiv) dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesit (legjitimimin pasiv), duke e justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e gjykatës për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga veprimi i të tredit (legitimatio ad causam).⁴

8. Përcaktimi i legjitimitetit është një çështje që nuk ka lidhje me procesin, d.m.th. me normat procedurale, por me të drejtën materiale. Pra, përcaktimi i tij duhet të bëhet mbi bazën e të drejtës materiale dhe konkretisht mbi bazën e normës materiale të shkelur. Mungesa e legjitimitetit e bën pretendimin të pathemeltë dhe për pasojë të papranueshëm për gjykatën. Me

² Vendimi Nr. 91, datë 19 Mars 2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

³ Vendimi Nr. 363, datë 11.06.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; Vendimi Nr. 264, datë 18.04.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

⁴ Vendimi Nr.800, datë 06 Qershor 2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

ngritjen e padisë, paditësi pretendon një të drejtë materiale të shkelur, pra duhet të gjejë një norme juridike të shkelur dhe një pasojë juridike që ka ardhur nga shkelja e kryer. Ligji procedural nuk mund të zbatohet pa një normë të së drejtës materiale, pasi ky ligj rregullon pikërisht marrëdhëniet e organit gjyqësor, procedurën e zbatimit të së drejtës materiale nga pushteti gjyqësor. Shteti shfaqet nëpërmjet gjykatës dhe jep mbrojtjen juridike nëpërmjet një vendimi gjyqësor. Pra pala që kërkon detyrimin e shtetit për të kryer një veprim, d.m.th. të sigurojë një mbrojtje, duhet të përcaktojë në kërkesë padi normën e shkelur.⁵

9. Në këto kushte, nëse paditësi gjatë gjykimit nuk do të vërtetonte të drejtën subjektive të shkelur, e cila gjen pasqyrim në të drejtën materiale, atëhere do të ndodheshim përpara mungesës së legjitimitimit real, i cili nuk do t'i humbiste palës të drejtën për të ngritur padi, por nuk do të çonte në rrëzimin e saj si të pabazuar. Legjitimitimi real (*legitimitio ad causam*) nënkupton marrëdhënien subjektive mes paditësit dhe të paditurit ndaj së drejtës subjektive për mbrojtjen e së cilës është vënë në lëvizje procesi gjyqësor. Pala ndërgjyqëse gëzon legjitimitim real nëse gjatë gjykimit vërteton se e drejta subjektive që rrjedh nga marrëdhënia juridiko-civile-administrative me të cilën lidhet konflikti, i takon asaj dhe palës tjetër. Pra, është e drejta materiale ajo që përcakton legjitimitimin real të palëve ndërgjyqëse në gjykim dhe në këtë kuptim vetë thelbi i gjykimit është përcaktimi se cilës palë i takon realisht e drejta subjektive.⁶

10. Shoqata Kombëtare e Gjuetarëve të Republikës së Shqipërisë (në vijim SH.K.GJ.R.SH) në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 15, shkronja “d” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, legjitimohen *ratione personae* t’i drejtohen me padi Gjykatës Administrative të Apelit. SH.K.GJ.R.SH në kuptimin që e përdor neni i sipërcituar i këtij ligji është shoqatë, regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 2160, datë 25.01.2008. SH.K.GJ.R.SH legjitimohet *ratione materiae*, në lidhje me pretendimin e saj për paligjshmërinë e VKM nr. 389/2019 në pjesën që nuk parashikon në Lidhjen 2 të saj gjyqtarët si subjekte zyrtarë që kanë të drejtë të pajisen me pasaportë shërbimi si dhe për pikën 14 të saj në pjesën që parashikon se pasaportat e shërbimit të gjyqtarëve të lëshuara para datës 14 Qershor 2019 humbin vlefshmërinë me datë 31 Dhjetor 2019.

11. SH.K.GJ.R.S.H nëpërmjet kësaj padie pretendon se është cenuar një interes i rëndësishëm publik dhe konkretisht statusi i gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, si pjesë e pavarësisë së tyre në ushtrimin e funksionit, nga ana e një akti normativ nënligjor, sikurse është VKM nr. 389/2019. Në nenin 3 të Statutit të SHKGRSH-së, nën titullin “Qëllimi dhe veprimtaria”, ndër të tjera përcaktohet shprehimisht se: “Shoqata ka këto qëllime dhe kryen këto veprimtari: ... zhvillimin dhe implementimin e statusit të gjyqtarëve në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me standardet ndërkombëtare në këtë fushë; synon mbrojtjen dhe garantimin e statusit të gjyqtarëve, si dhe ruajtjen e pavarësisë dhe garancive të tjera të pushtetit gjyqësor.”.

12. Gjithashtu, SH.K.GJ.R.S.H legjitimohet *ratione temporis*, pasi VKM nr. 389/2019 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë viti 2019, ditën e premte, me datë 14 Qershor 2019. Në pikën 15, në paragrafin e dytë parashikohet se ky vendim hyn në fuqi pas botimit në

⁵ Vendimi Nr. 539, datë 31 Mars 2005 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

⁶ Vendimi Nr. 363, date 11.06.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; Vendimi Nr. 264, datë 18.04.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Fletoren Zyrtare. Kjo do të thotë se VKM nr. 389/2019 ka hyrë në fuqi me datë 14 Qershor 2019 dhe për rrjedhojë padia është paraqitur brenda afatit tre vjeçar të hyrjes në fuqi të këtij akti nënligjor normativ, siç përcaktohet në nenin 18, pika 3, të ligjit “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

13. Gjykata e Apelit Administrativ ka kompetencë lëndore dhe funksionale për shqyrtimin e kësaj çështje pasi në nenin 10, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, përcaktohet se kjo gjykatë gjykon në shkallë të parë mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative.

2. Në lidhje me themelin e pretendimeve.

14. Statusi i gjyqtarit, si një nga elementët e pavarësisë së tij, përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet (kufizimet) që ai mbart për shkak të ushtrimit të këtij funksioni kushtetues. Ndër të drejtat që gjyqtarët gëzojnë, si pasojë e pasjes së statusit të tyre, janë paga dhe përfitimet e tjera me natyrë financiare dhe jo financiare. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” merr përsipër mënyrën e përllogaritjes së pagës së gjyqtarëve si dhe disa prej përfitimeve të tjera financiare, duke qenë një ndër elementët më themelore të statusit të këtyre funksionarëve kushtetues. Ndërkohë, me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, përkatësisht ligjvënësi dhe pushtetit ekzekutiv, mund të akordojnë privilegjeve të tjera për këtë kategori funksionarësh (gjyqtarët) si pjesë e të drejtave që burojnë nga statusi. Në momentin që këto privilegjeve, sikurse mund të jetë pasaporta e shërbimit apo ajo diplomatike, akordohen, ato bëhen pjesë e statusit të funksionarit në fjalë. Në një situatë të tillë privilegji, i dhënë me çdo lloj akti ligjor apo nënligjor, bëhet pjesë e statusit dhe nuk mund të cenohet me akte të mëtejshme ligjore apo nënligjore. Të vetmet përjashtime për të cilat statusi mund të preket në aspektin përkeqësues janë parashikuar në nenin 138 të Kushtetutës si dhe në nenin 22 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çka nuk provohet të ekzistojë në situatën konkrete.

15. Shtrirja e statusit të gjyqtarit edhe ndaj përfitimeve të tjera, krahas atyre me natyrë ngushtësisht financiare del jo vetëm nga përmbajtja e nenit 138 të Kushtetutës si dhe nenit 22 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por është konfirmuar edhe nga jurisprudenca konstante e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Në disa vendime të saj kjo gjykatë është shprehur se me termin “përfitime të tjera”, duhen kuptuar jo vetëm ato me natyrë financiare por edhe të drejta të tjera, sikurse mund të jetë p.sh e drejta për karrierë e gjyqtarit, të cilat pasi u jepen u këtyre të fundit, nuk mund tu hiqen më, pasi mbrohen nga parimet kushtetuese të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të sigurisë juridike, të cilat në drejtim të gjyqtarit kanë krijuar koracën e statusit të tij.

16. Një nga parimet më të rëndësishme të sanksionuara në disa norma kushtetuese është edhe pavarësia e pushtetit gjyqësor. Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave nuk është e sanksionuar si privilegj apo qëllim në vetvete, por ajo lidhet me mirëfunksionimin e shtetit dhe të drejtën e shtetasve për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe funksional, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës (**shih vendimet nr. 31, datë 02.12.2009 dhe nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese**). Gjykata ka theksuar se statusi ligjor i gjyqtarëve duhet të jetë në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Parimi i pavarësisë së gjyqësorit përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të

cilat të marra së bashku, krijojnë kushtet e nevojshme që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, me mosndjekjen e tyre penalisht pa pëlqimin e KLD-së dhe disiplinarisht pa vendim të motivuar të KLD-së, si dhe me garancitë financiare (*shih vendimet nr. 5, datë 16.02.2012; nr. 26, datë 24.07.2009; nr. 11, datë 02.04.2008 dhe nr. 11, datë 27.05.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Sistemi i garancive që gëzojnë gjyqtarët parashikohet edhe në dokumente ndërkombëtare. Kështu, Karta Evropiane për statusin e gjyqtarit, në paragrafin 1/1, shprehet se statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elementë këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Gjithashtu, “Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit” (miratuar me Rezolutat 40/32, datë 29 nëntor 1985 dhe 40/146, datë 13 dhjetor 1985 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së), në paragrafin 11, sanksionojnë se mandati i gjyqtarëve, pavarësia e tyre, siguria, paga e përshtatshme, kushtet e shërbimit, pensionet dhe moshja e daljes në pension duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme (*shih vendimin nr. 31, datë 02.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në vendimin Nr. 40, datë 07.07.2014 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera ka theksuar se: “19. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, neni 138 i Kushtetutës përcakton elementë përbërës të statusit të gjyqtarit, pa të cilët nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të tyre. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elementë të tjerë që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Formulimi i togfjalëshit “përfitime të tjera” është i një natyre të përgjithshme dhe nuk konkretizon në mënyrë shteruese rrethin e përfitimeve të gjyqtarëve. Kushtetutbërësi, jo pa qëllim e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë rrethit të përfitimeve, pasi ka synuar të përfshijë në të tërësinë e të drejtave që gjyqtarët i gëzojnë në funksion të ushtrimit të detyrës së tyre (shih vendimin nr. 31, datë 02.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese)....

23. Parimi i sigurisë juridike mbron garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës, ku përfshihet edhe e drejta e karrierës, si pjesë përbërëse e statusit të gjyqtarit dhe një nga përfitimet e tjera që gjyqtarët gëzojnë, për shkak të funksionit. Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Qëllimi i parimit të sigurisë juridike është të sigurojë besimin e personave të shteti e ligji dhe, vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë duhet të gëzojnë një besim të tillë. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai mund të vendosë dhe kufizime, por këto kufizime duhet të bëhen vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e të drejtës dhe garancisë (*shih vendimet nr. 11, datë 06.03.2014; nr. 9, datë 26.02.2007; nr. 11, datë 04.04.2007; nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 26, datë 02.11.2005; nr. 34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).”.

19. Në vendimin Nr. 20, datë 01.06.2011 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera thekson se: **“Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (Shih vendimin nr. 5 datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese). Nisur nga tagrat që i jep neni 124 i Kushtetutës, roli dhe funksioni i Gjykatës Kushtetuese është që nëpërmjet vendimeve të transformojë dispozitat kushtetuese nga abstrakte-metafizike, në substanciale dhe konkrete, duke i garantuar mbrojtje kushtetuese situatave juridike në të cilat ndodhen individët. Për shkak të vetë formës ekstremisht konçize që kanë dispozitat kushtetuese, nëpërmjet vendimeve, pra interpretimit që bën Gjykata, bëhet e mundur që Kushtetuta të jetë “e gjallë”, që do të thotë se Gjykata i përshtatet evolucionit që bëjnë vlerat në vendin tonë, duke garantuar që vlera të reja, të cilat ndoshta nuk ishin në vëmendje të hartuesve të Kushtetutës, të marrin dinjitet, njohje dhe, mbi të gjitha, mbrojtje kushtetuese. Për vetë faktin se norma kushtetuese bëhet realitet gjatë interpretimit, pra gjatë procesit vendimmarrës të Gjykatës, e bën këtë të fundit pa diskutim burim të së drejtës, për më tepër e bën atë një burim parësor të saj, duke pasur parasysh se neni 4 i Kushtetutës parashikon se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.”** Pra, sipas këtij vendimi, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë të njëjtë fuqi me Kushtetutën që ka epërsi mbi aktet e tjera normative të parashikuara nga neni 116 i Kushtetutës.

20. Kushtetuta në nenin 138 të saj ka garantuar gjyqtarët lidhur me statusin e tyre, në pjesën e të drejtave që rrjedhin nga ushtrimi i detyrës, duke parashikuar se pagat dhe përfitimet e tjera nuk mundet të ulen. Në të njëjtën kohë ajo ka parashikuar edhe përjashtimet nga ky rregull si një rezervë kushtetuese. Përjashtimet nga ky rregull kushtetues janë: **a)** nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko – financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare; **b)** gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit; **c)** i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit. Në të njëjtën mënyrë ka rregulluar dhe detajuar edhe Ligji nr. 96/2016, duke përfshirë në këtë garanci edhe magjistratët prokurorë.

21. Në rastin konkret konstatohet se gjyqtarët, ndër të drejtat që gëzonin për shkak të ushtrimit të detyrës dhe pjesë e statusit të tyre, ka qenë e drejta për t’u pajisur me pasaportë shërbimi dhe të drejtën që pajisja me pasaportë të realizohej me shpenzimet e institucionit. Ajo që ka ndodhur me VKM nr. 389/2014 është prekja e statusit të gjyqtarëve në dy elementë:

- 1) Heqja e së drejtës për t’u pajisur me pasaportë shërbimi dhe për rrjedhojë heqja e së drejtës për të gëzuar të gjitha lehtësitë e pajisjes me këtë dokument shtetëror identifikimi, të cilat kanë dhe impakt financiar. Kjo për faktin pasi në disa vende mbajtësit e pasaportave të shërbimit mund të shkojnë pa viza, për rrjedhojë nuk paguajnë tarifën e pajisjes me vize në ambasada, ndryshe nga mbajtësit e pasaportave të zakonshme të cilët janë të detyruar të bëjnë pagesën e vizës.
- 2) Heqja e përfitimit financiar të përballimit të pagesës së pajisjes me pasaportë shërbimi nga buxheti i institucionit ku gjyqtari ushtron detyrën.

22. Vlerësojmë se shkronja “b” dhe “c” e nenit 138 të Kushtetutës dhe nenit 22 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” nuk ka relevancë kushtetuese dhe ligjore që të jetë përdorur dhe të jetë zbatuar në VKM nr. 389/2019. I vetmi shkak justifikues i legjitimitetit të VKM nr. 389/2019 është shkronja “a” e nenit 138 të Kushtetutës dhe nenit 22 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Kjo do të thotë se që të marrë legjitimitet ky akt nënligjor normativ do të duhet të ketë pasur një situatë të vështirë financiare në vend ose emergjenca të tjera kombëtare. Për rrjedhojë konkludohet se VKM nr. 389/2019 në pjesën e “Lidhjes 2”, në pjesën që ka ometuar për të përfshijë gjyqtarët si subjekte zyrtarë që gëzojnë të drejtën për t’u pajisur me pasaportë shërbimi vjen në kundërshtim me nenin 138 të Kushtetutës dhe neni 22 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet shprehimisht se: “1. Paga dhe përfitimet e tjera të magjistratit **nuk mund të ulen**”. Kjo bën që VKM nr. 389/2019 në pikën 14, ku ka kufizuar të drejtën e përdorimit të pasaportave të shërbimit të gjyqtarëve deri në datë 31.12.2019, vjen në kundërshtim me nenin 138 të Kushtetutës dhe nenin 22 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, vlerësojmë se VKM nr. 389/2019 në pjesët e identifikuara më lart ka shkelur nenin 118 të Kushtetutës, duke qenë se kanë dalë në kundërshtim me vetë rezervën kushtetuese, në të cilën theksohet se: “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.” dhe rezervën ligjore të paprekshmërisë së statusit të gjyqtarëve.

3. Konkluzioni.

23. Sa më sipër u arsyetua, kërkojmë nga Gjykata Administrative e Apelit pranimin e padisë sipas objekt dhe botimin në Fletoren Zyrtare të vendimit.

PADITËSI

SHOQATA KOMBËTARE E GJYQTARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËRFAQËSUAR

NGA

FLORJAN KALAJA

ENGERT PËLLUMBI